

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5443
E enjte, 5 prill 2018
çmimi 0.40 €

Thaçi: Kosova ka bërë
progres në luftën kundër
korrupsionit | **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEHXHET SHALA | **FAQE 4-5**

Kërkesa për zgjedhje të reja, joserioze



Analisti politik Behxhet Shala ka vlerësuar se kërkesa për zgjedhje të reja më tepër është një kërcënim sesa përpjekje serioze e subjekteve politike. Ai ka thënë se nuk ka gatishmëri dhe kushte për mbajtje të zgjedhjeve të parakohshme. Madje, sipas Shalës,

mbajtja e zgjedhjeve nuk do të kishte kuptim pa u kryer një reformë e thellë zgjedhore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se opozita nuk do të parashtrijë mocion të mosbesimit ndaj Qeverisë aktuale. Sipas Shalës, Lëvizja

Vetëvendosje dhe Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk do të bëhen bashkëpunëtorë të Listës Serbe për rrëzimin e Qeverisë. Pavarësisht prej problemeve, ai ka thënë se Qeveria Haradinaj do të vazhdojë të funksionojë edhe për një kohë


Deputetët thonë se Kosova bëri veprim skandaloz me dëbimin e shtetasve turq

Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur të mërkurën rreth dëbimit të gjashtë shtetasve turq, të cilët ishin drejtues dhe

mësues të Kolegjit "Mehmet Akif", vlerësuan se shteti i Kosovës bëri veprim skandaloz rreth mënyrës se si i ka deportuar ata në Turqi, duke shkelur të



drejtat e njeriut. Deputetët gjatë debatit theksuan se në këtë situatë mbetën të shtangur kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, por jo edhe presidenti | **FAQE 7**



'Trepça' bëhet me bord

Esat Peci, Feriz Fetahu, Xhaver Nura, Shyqeri Sadiku, Ardian Sylja dhe Naser Peci janë emëruar anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të "Trepçës".

Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se ky bord në ditët e ardhshme do të plotësohet edhe me tre anëtarë të tjerë | **FAQE 8**

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel & Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjobiznesi.com
info@kolegjobiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

KOSOVA ARRITI PAVARËSINË E SAJ PARA NJË DEKADE, TANI RRUGËTON DREJT ANËTARËSIMIT NË BE | **F. 6**

Nga Bekim ÇOLLAKU dhe
Antonia BATTAGLIA

EMËROHEN ANËTARËT E RINJ TË AGJENCISË SË AKREDITIMIT | **F. 6**

SBASHK-U, NËSE NUK I PËRMBUSHEN KËRKESAT, FILLON GREVËN JAVËN E ARDHSHE | **F. 6**

EKONOMI

OEK-U: NORMAT E LARTA TË KAMATAVE, SFIDAT KRYESORE NË SEKTORIN E NDËRTIMIT | **F. 8**

BRUTO PRODUKTI VENDOR SHËNON RITJE 3.2 PËR QIND | **F. 9**

KULTURË

HAPET ZYRA E SEKRETARIATIT PËR NDER TË VITIT MBARËKOMBËTAR TË SKËNDERBEUT | **F. 13**

SPORT

GASHI: STADIUMI I PRISHTINËS, I GATSHËM NË QERSHOR | **F. 18**

PRISHTINA AFËR FINALES, DERBI KUQEZI PËRFUNDON PA FITUES | **F. 18**

Basha: Ramën do ta rrëzojmë

TIRANË, 4 PRILL - Krerët e koalicionit opozitar kanë reaguar pas dhënies së vendimit për arrest me burg për 11 protestuesit kundër vendosjes së taksës në "Rrugën e Kombit".

Lulzim Basha dhe Monika Kryemadhi e cilësuan skandal vendimin e gjyqtarës së Kukësit. Basha bëri fajtor kryeministri Edi Rama dhe premtoi se me këtë vendim politik Rama i ka orët e numëruara.

Ndërkohë kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, në një deklaratë

urgjente nga selia e partisë, deklaroi se pas këtij vendimi skandaloz të gjykatës fjalën e ka populli, pasi politika nuk ka më asnjë funksion.

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, doli në një deklaratë për mediet pas lënies në burg të 11 nga protestuesit për taksën në "Rrugën e Kombit", duke thënë se ky është një regjim që burgos popullin dhe lë kriminelët të lirë. "Shumë nga të ndaluarit u grabitën në mes të natës nga policia. Çfarë lidhje ka ky regjim që liron Orest Sotën dhe mban

në burg, babanë e tre fëmijëve të arrestuar në mes të natës sikur të ishte një terrorist. Ky është një shtet që shkel liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Ky është një regjim që burgos popullin dhe lë kriminelët të lirë", tha Basha.

Deklaratat e ashpra të opozitës vijnë edhe pas heshtjes së mazhorancës dhe provokimeve të kryeministrit Edi Rama. Deputetët e opozitës u ndaluan në mënyrë brutale nga policia që të merrnin pjesë në seancë, si dhe pati përplasje fizike.



Rama: BE-ja t'i heqë vizat për Kosovën

Në konferencën ballkanike të të majtëve të rajonit, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka kërkuar që Bashkimi Evropian ta mbajë fjalën dhe ta liberalizojë lëvizjen për të gjithë qytetarët e Kosovës, ndërsa Albin Kurti i ka kërkuar Tiranës ta heqë taksën e Rrugës së Kombit

TIRANË, 4 PRILL - Nën përkujdesjen e Partisë Evropiane Socialiste në Tiranë është mbajtur të mërkurën konferenca ballkanike e të majtëve të rajonit, ku Kosova është përfaqësuar kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. Në këtë konferencë kryeministri i Shqipërisë, njëherësh kryetar i Partisë Socialiste (PS), Edi Rama, ka kërkuar nga Brukseli që të mbajë fjalën për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. "Për ne shqiptarët është me rëndësi që Bashkimi Evropian ta mbajë fjalën dhe ta liberalizojë lëvizjen për të gjithë qytetarët e



Kosovës dhe jam i bindur se presidenti i Partisë Socialiste Evropiane ndan të njëjtin qëndrim", ka thënë Rama.

Ndërsa Albin Kurti i ka kërkuar Tiranës ta heqë taksën e Rrugës së Kombit. "Taksa është e shtrenjtë, kosovarët nuk janë të pasur. Është më mirë mirëmbajtja nga taksat e shtetit", ka deklaruar Kurti.

Kryeministri Edi Rama në përfundim të Konferencës së Partive Socialiste Evropiane, theksoi se në konferencë u diskutua për rekomandimin e hapjes së negociatave për anëtarësim. Ai tha se Shqipëria pret rekomandimin e hapjes së negociatave për anëtarësim. Por, sipas kryeministrit, procesi i afrimit me BE-në ka një tjetër anë

të medaljes për Shqipërinë, që BE-ja ta mbajë fjalën dhe t'i liberalizojë vizat për të gjithë kosovarët. I pyetur lidhur me akuzat e opozitës, Rama e ka anashkaluar këtë çështje duke thënë se në prani të angjshftfolësve nuk flet për opozitën. Ndërsa lidhur me çështjen e protestës për tarifën në Rrugën e Kombit, Rama u përgjigj shkurt se

shqetësimi i tij i vetëm është çfarë do të bëjnë konkretisht për njerëzit që jetojnë në Kukës. "Problemi im sot dhe këtyre ditëve ka qenë zgjidhja që duam dhe do t'i japim atyre që janë realisht subjekt i sistemit të pagesës dhe patjetër që në fund do të vlejë se ç'do të bëjmë për njerëzit që jetojnë në Kukës. Kur flas anglisht, nuk flas për opozitën e vendit tim", tha Rama. Ndërkohë, presidenti i PES, Sergei Stanishev, theksoi në fjalën e tij se, "jemi këtu me mesazhe të mira politike për shqiptarët". Ai vlerësoi reformën në drejtësi dhe bëri thirrje për bashkëpunim mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Jemi këtu me mesazhe të mira politike për shqiptarët. Gjatë javëve të ardhshme do të kemi ngjarje mjaft të rëndësishme jo vetëm për Shqipërinë, por të gjithë Ballkanin Perëndimor. Është bërë një reformë shumë e vështirë. Sistemi i drejtësisë do të jetë transparent. Ky është një kredit vetëm i Ramës dhe PS-së. Duhet të përgëzohet edhe fushata kundër kanabisit dhe ky është një moment shumë i rëndësishëm. Është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi i rajonit, duke përfshirë edhe Shqipërinë", tha presidenti i PES-së, Sergei Stanishev.

Përgjysmohet taksa për Kukësin

TIRANË, 4 PRILL - Qeveria ka nisur negociatat me koncesionarin e "Rrugës së Kombit" në lidhje me rishikimin e tarifave për përdoruesit e banorët e zonës që preken. "Top Channel" ka mësuar se po bisedohet për të pasur një ulje rreth 50% të tarifës, ndërkohë në komisionin e ekonomisë, ministri i Financave pranoinisjen e negociatave përpara afateve të përcaktuara në kontratë. Rezultatet priten brenda dy javësh. "Kontrata, në logjikën e saj, i refero-

het negociatës pasi të dalin statistikat. Kryeministri ka kërkuar që kjo negociatë të bëhet përpara se të dalin statistikat për të përfshirë si një paketë sociale solidariteti", tha ministri Ahmetaj. Opozita nuk ishte e pranishme në raportimin në komision të ministrit Ahmetaj, ndërkohë që kryetari Erion Braçe kërkoi pikërisht që të ketë lehtësira për banorët që preken nga vendosja e tarifave për kalimin në "Rrugën e Kombit". "Një

kategori e caktuar, qoftë përdoruesish atje, qytetarë, banorë të zonës, duhet të përjashtohen nga pagesa e asaj tarifë. Do të doja të dija, nëse ju po i mëshoni kësaj pike në negociatat që ju po bëni me koncesionarin", tha Braçe. "Kontratat që do t'ndryshojë i referohet një procedure shumë të holl'ishme, rigorozë ligjore, që kalon në një sërë filtrash. Ato që ju keni shqetësime janë në tryezën e negociatës", tha ministri Ahmetaj.



Është mbajtur takimi i Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Thaçi: Kosova ka bërë progres në luftën kundër korrupsionit



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shprehur përkushtimin e institucioneve të Kosovës për ta vazhduar luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit ai ka deklaruar se Kosova ka shënuar progres në këtë drejtim, por ka përmendur edhe sfidat që ka vendi ynë në këtë proces

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 4 PRILL - Liderët e shtetit kanë konstatuar se Kosova ka bërë progres në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në mbledhjen e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit ata kanë shprehur përkushtimin e institucioneve që të bëjnë edhe më shumë për forcimin e sundimit të ligjit dhe të punohet më me profesionalizëm.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i cili e ka thirrur këtë mbledhje, ka bërë një bilanc të dhjetë vjetëve shtet, përgjatë të cilëve Kosova ka marrë një sërë veprimesh me qëllim të konsolidimit të sundimit të ligjit dhe në funksion të respektimit të rendit kushtetues. "Ne e dimë se lufta ndaj krimit të organizuar dhe

korrupsionit nuk është e lehtë, por ne duhet të ecim përpara. Sfidat duhet t'i tejkalojmë me bashkëpunim, profesionalizëm dhe përkushtim të secilit prej neve", ka thënë Thaçi. Ai ka përmendur edhe sfidat që janë përcjellë nga takimet e Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit. "Bashkëpunimi institucional, funksionimi i mekanizmave të sundimit të ligjit, zbatimi i legjislacionit në fuqi, ndjekja, hetimi dhe gjykimi i krimit të organizuar në përgjithësi dhe korrupsionit në veçanti, aplikimi i metodave dhe teknikave të sofistikuara hetimore, rritja e numrit të rasteve konkrete që përfundojnë me aktgjykime dënuese, harmonizimi i statistikave lidhur me rastet, parashkrimi i lëndëve, ngritja e kapaciteteve të institucioneve të zbatimit të ligjit në fusha specifike, duke marrë parasysh zhvillimin e

teknologjisë, forcimi i kontrollit të brendshëm të institucioneve dhe zbatimi i dokumenteve të politikave të kësaj fushe janë adresuar gjithnjë si sfida", ka deklaruar Thaçi. Ai ka thënë se disa prej këtyre sfidave janë adresuar, kurse disa të tjera kanë mbetur për t'u adresuar dhe institucionet përkatëse janë duke i ndërmarrë veprimet e nevojshme. "Në ditët në vijim do të fillojë procesi i rishikimit të mandatit dhe funksionimit të këtij Këshilli, me qëllim të dinamizmit dhe avancimit të punës së tij dhe në funksion të garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve", është shprehur Thaçi. Ai ka thënë se janë bërë hapa konkretë për forcimin e luftës ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, për përpushjen e kriterit të fundit për liberalizimin e vizave nga Bashkimi Evropian. "Tani pres nga të gjitha institucionet që të dëshmojnë këtë progres dhe ky progres të vlerësohet nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe të ecet përpara me liberalizimin e vizave", ka thënë ai. Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka theksuar përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për përkrahjen e reformave në drejtësi, në rend dhe

ligj, në të njëjtën kohë edhe përkrahjen buxhetore për institucionet e rendit dhe ligjit. "Kosova është duke e kaluar një periudhë të rëndësishme në reformat e përgjithshme, reforma që janë të domosdoshme, por reforma, po ashtu, që e kanë në fokus sistemin e drejtësisë dhe të cilat kanë filluar të japin rezultate", ka thënë Haradinaj. Ai ka treguar se Qeveria që ai drejton deri tani ka zhvilluar një sërë takimesh të nivelit të lartë për sundim të rendit dhe të ligjit, në të cilat kryesuesit e institucioneve të rendit dhe ligjit, të luftës kundër krimit e korrupsionit, kanë raportuar për gjendjen në këto institucione veç e veç. Sipas tij, në fushën e gjyqësisë është bërë shumë punë, e cila do të përmbledhet në një publikim të përbashkët me ndihmën edhe të aktorëve relevantë, të Komisionit Evropian, Ambasadës së ShBA-së dhe përmes tyre të vërtetohet që Kosova vërtet është serioze në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, kundër të gjitha llojeve të krimit dhe kërcënimeve të shoqërisë sonë. "Duke dashur të konfirmoj këtë si proces dhe si garancë që ka përkushtimin e institucioneve të nivelit më të lartë, ashtu siç vërtetohet edhe sot, të bartësve

të institucioneve, përkrahjen buxhetore dhe përkrahjen e opinionit të gjerë, atëherë jam i bindur se Kosova do të kthehet në storie të suksesit në luftën kundër korrupsionit", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ai ka përmendur faktin se liberalizimi i vizave është një çështje më urgjente për të cilën qytetarët e vendit kanë prituri gjatë, duke shprehur besimin se në ditët që vijnë Bashkimi Evropian do të mund ta japë lajmin e shumëpritur për liberalizimin e vizave. Ndërsa kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka deklaruar se në luftën kundër korrupsionit nuk duhet të falet askush. "Lufta kundër korrupsionit duhet të jetë e vazhdueshme dhe e qëndrueshme, mirëpo edhe pushtetet e tjera ai ekzekutiv e legjislativ duhet ta japin kontributin e vet në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Pasojat e korrupsionit janë të mëdha", ka thënë Lumezi.

Në këtë mbledhje ka folur edhe ministri i Drejtësisë, Abeldar Tahiri, i cili ka thënë se ministria që ai drejton është duke avancuar sa i përket luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Sipas tij, aty ku është parë e nevojshme, dënimet që lidhen me korrupsion janë rritur ndjeshëm.

Haradinaj pret nga Thaçi të marrë vendim për drejtorin e AKI-së



PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Vendimi i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, për lirimin nga detyra të shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Driton Gashi, nuk bëhet i plotfuqishëm pa miratimin e presidentit Hashim Thaçi. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përsëritur se pas vendimit të tij, tani shkarkimi i

Gashit nga posti i shefit të AKI-së do të ndodhë pasi që vendimin ta marrë edhe presidenti i shtetit, Hashim Thaçi. Këto komente kryeministri Haradinaj i ka bërë të mërkurën pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës. Ndërkaq, në lidhje me largimin nga detyra të ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, kryemi-

nistri Haradinaj ka thënë se kjo ka ndodhur për shkak se arrestimi dhe më pas deportimi i gjashtë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi kishte prishur marrëdhëniet institucionale në mes të kryeministrit me ministrin e Punëve të Brendshme dhe drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Flet për "Epokën e re", Behxhet Shala

Kërkesa për zgjedhje



Analisti politik Behxhet Shala ka vlerësuar se kërkesa për zgjedhje të reja më tepër është një kërcënim sesa përpjekje serioze e subjekteve politike. Ai ka thënë se nuk ka gatishmëri dhe kushte për mbajtje të zgjedhjeve të parakohshme. Madje, sipas Shalës, mbajtja e zgjedhjeve nuk do të kishte kuptim pa u kryer një reformë e thellë zgjedhore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se opozita nuk do të parashtrojë mocion të mosbesimit ndaj Qeverisë aktuale. Sipas Shalës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk do të bëhen bashkëpunëtorë të Listës Serbe për rrëzimin e Qeverisë. Pavarësisht prej problemeve, ai ka thënë se Qeveria Haradinaj do të vazhdojë të funksionojë edhe për një kohë

Veseli, Ramush Haradinaj e Fatmir Limaj. Por, tash për tash, bashkësisë ndërkombëtare i duhen muskujt e këtyre për t'i çuar përpara këto procese të cilat në disa raste edhe e dëmtojnë Kosovën", ka theksuar Shala.

"Epoka e re": Z. Shala, pas zhvillimeve të fundit, përkatësisht pas largimit të Listës Serbe, si e shihni funksionimin e koalicionit qeverisës. Mund të vazhdojë Qeveria Haradinaj punën pa shumicën e thjeshtë në Kuvend?

Shala: Qeveria me këtë përbërje do të vazhdojë për faktin se është e vetmja që mund t'i çojë përpara disa procese siç janë Asociacioni, Gjykata Speciale dhe dialogu me Serbinë, të cilat janë projekte të bashkësisë ndërkombëtare. Po të ishte një situatë normale në Kosovë kurrë bashkësia ndërkombëtare nuk do të lejonte të qeverisin Kosovën, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Ramush Haradinaj e Fatmir Limaj. Tash për tash

bashkësisë ndërkombëtare i duhen muskujt e këtyre për t'i çuar përpara këto procese të cilat, në disa raste, edhe e dëmtojnë Kosovën. Prandaj bashkësia ndërkombëtare nuk ka asnjë interesim për ta rrëzuar këtë Qeveri. Kurse sa i përket shumicës së thjeshtë në Kuvend, opozita nuk do të thotë se duhet ta kundërshtojë çdo ligj i cili dërgohet në Kuvend për miratim. Pra, opozita do ta përkrähë çdo ligj i cili është në dobi të qytetarëve të Kosovës. Do të thotë, në këtë mënyrë, pavarësisht prej problemeve, Qeveria Haradinaj do të vazhdojë tutje. Në fakt, është një situatë e rëndë, por Qeveria do të vazhdojë edhe për një kohë. Tash për tash këta lojtarë në skenën politike janë të pazëvendësueshëm, sepse kanë mision për të përmbushur një agjendë të bashkësisë ndërkombëtare.

"Epoka e re": Opozita ka paralajmëruar ngritjen e një mocioni të mosbesimit ndaj Qeverisë

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 4 PRILL - Njohësi i rrethanave politike, njëherësh drejtor ekzekutiv i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), Behxhet Shala, ka thënë se kërkesa për zgjedhje të reja është joserioze. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se nuk ka gatishmëri dhe kushte për mbajtje të zgjedhjeve të

parakohshme. Ai ka shprehur skepticizëm sa i përket ngritjes së mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë Haradinaj. Sipas Shalës, as Lëvizja Vetëvendosje dhe as Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk do të bëhen bashkëpunëtorë të Listës Serbe për rrëzimin e Qeverisë. Ai ka theksuar se askush nuk dëshiron që vota për rrëzimin e Qeverisë të identifikohet me kërkesën e Listës Serbe, e cila është skajshmërisht kundër Kosovës dhe interesave të saj. Pavarësisht prej

problemeve, Shala ka thënë se Qeveria Haradinaj do të vazhdojë të funksionojë edhe për një kohë. "Qeveria në këtë përbërje do të vazhdojë sepse është e vetmja që mund t'i çojë përpara disa procese siç janë Asociacioni, Gjykata Speciale dhe dialogu me Serbinë të cilat janë projekte të bashkësisë ndërkombëtare. Po të ishte një situatë normale në Kosovë, kurrë bashkësia ndërkombëtare nuk do të lejonte të qeverisin Kosovën Hashim Thaçi, Kadri

të reja, joserioze



aktuale. Prisni një mocion të tillë?

Shala: Nuk besoj se opozita do të parashtojë mocion të mosbesimit ndaj Qeverisë aktuale. As Lëvizja Vetëvendosje e as Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk mendoj se do të bëhen argatë të Listës Serbe për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj. Askush nuk dëshiron që vota për rrëzimin e Qeverisë të identifikohet me kërkesën e Listës Serbe, e cila është skajshmërisht kundër Kosovës dhe interesave të saj. Është e pamoralshme që Lista Serbe të shërbejë si pretekst për rrëzimin e Qeverisë kur ka 100 arsye të tjera të cilat mund të përdoren për ta larguar këtë Qeveri. Nuk shoh një mjedis i cili do të shkonte në favor të mocionit për rrëzimin e Qeverisë.

"Epoka e re": Si e shihni kërkesën e partive opozitare për zgjedhje të reja parlamentare?

Shala: Kërkesa për zgjedhje të reja më tepër është një kërcënim sesa përpjekje serioze e subjekteve politike. Nuk ka gatishmëri dhe as kushte për mbajtje të zgjedhjeve të parakohshme. Madje mbajtja e zgjedhjeve nuk do të kishte kuptim pa u kryer një reformë e thellë zgjedhore. As institucioni që është përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve, KQZ-ja, nuk ka legjitimitet dhe nuk është e kompletuar. LDK-ja është e vetmja që po ngulmon për zgjedhje dhe po kërkon të caktohet data e tyre. Edhe Lista Serbe është shprehur për zgjedhje të reja. Subjektet e tjera nuk janë të interesuara për zgjedhje. Madje kryeministri Haradinaj ka bërë humor me LDK-në duke thënë se 'nëse doni

zgjedhje, ne ua japim edhe votat tona'. Përcaktuese për mbajtjen apo mosmbajtjen e zgjedhjeve është bashkësia ndërkombëtare e cila, po të dëshironte zgjedhje, do të dërgonte një sinjal të qartë.

"Epoka e re": Pra, shumicës së partive nuk i konvenon shkuarja në zgjedhje?

Shala: Asnjë subjekt politik nuk është i sigurt për rezultatin në zgjedhje. LDK-ja, për taksirat të vetin, e ka marrë rolin e PDK-së në zgjedhjet e fundit e cila u çua peshë dhe ka pësuar duke u renditur e treta. LDK-ja po mendon se me ndarjen e Vetëvendosjes dhe përçarjen eventuale të partive në koalicion mund të fitojë, por kjo nuk do të ndodhë sepse do të ketë shpërndarje të votës. Realisht, të gjithë po deklarohen se janë të interesuar për të shkuar në zgjedhje. Shkuarja në zgjedhje nuk i konvenon as LDK-së e cila ka mungesë të lidhshimit. Pra, ka rryma të cilat pretendojnë ta zënë vendin e Isa Mustafës dhe kjo ndikon pastaj në rezultatin zgjedhor. PDK-ja nuk ka besim të shkojë në zgjedhje sepse aty kemi dy rryma. Është rryma e Hashim Thaçit, rryma e Kadri Veselit si dhe është një grup as për e as kundër, por që presin se kush do të fitojë dhe atij t'i shërbejnë. PDK-ja nuk ka interesim të shkojë në zgjedhje, por edhe nëse ka zgjedhje, PDK-ja do të ndahet më mirë se në zgjedhjet e fundit, ku u dëmtua nga koalicioni parazgjedhor. Edhe Lëvizja Vetëvendosje është ndarë dhe nuk i konvenojnë zgjedhjet. As Grupi i Deputetëve të Pavarur nuk ka interesim të shkojë në zgjedhje, sepse nuk është i sigurt

nëse do të kalojë mirë. Nisma Socialdemokrate e ka arritur atë maksimumin e mundshëm dhe nuk mund të arrijë më shumë, përkundrazi mund të shënojë rënie. I vetmi subjekt i cili mund të ketë rritje është AAK-ja. Listës Serbe i konvenon shkuarja në zgjedhje sepse është parti e Serbisë në Kosovë dhe e ka përkrahjen e Beogradit. Fatkeqësisht, e ka përkrahjen edhe të Thaçit dhe të tjerëve. I vetmi person që ka plotësisht arsye dhe vullnet për të shkuar në zgjedhje është presidenti Hashim Thaçi, i cili me zgjedhje të jashtëzakonshme do ta mbulonte skandalin e deportimit të shtetasve turq, çështjen e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe si dhe procesin e bisedimeve me Serbinë.

"Epoka e re": Po sikur të ketë zgjedhje të reja, do të ketë ndryshime në skenën politike?

Shala: Nuk pres të ketë zgjedhje, së paku jo brenda gjashtë muajve. Edhe nëse do të ketë, sipas mendimit tim, nuk do të ketë asnjë ndryshim në skenën politike. Asnjë parti nuk mund t'i fitojë zgjedhjet pa një koalicion parazgjedhor dhe pa një koalicion jonormal pas zgjedhjeve. Kosova nuk ka gatishmëri për të shkuar në zgjedhje sepse qytetarët janë lodhur nga proceset zgjedhore. As bashkësia ndërkombëtare nuk i pranon zgjedhjet e parakohshme sepse janë duke u zhvilluar disa procese, siç është Asociacioni, Gjykata Speciale dhe dialogu me Serbinë të cilat mund të shkojnë përpara me këtë klasë udhëheqëse.

Haradinaj e Thaçi riaktivizojnë ekipin menaxherial për asociacionin

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, bashkë me presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi, kanë riaktivizuar ekipin menaxherial i cili do ta bëjë draftimin e statutit për Asociacionin e Komunave Serbe. Draftimi i statutit do të jetë një proces transparent dhe gjithëpërfshirës, i cili do të përbëhet nga tre mekanizma punues: ekipi menaxhues, komiteti zbatues si dhe grupi nacional konsultativ, të cilët do të garantojnë përfshirje të gjithë

spektrit politik, të shoqërisë civile dhe të mekanizmave të tjerë relevantë të shoqërisë. Në këtë proces do të jenë të përfshirë edhe mekanizma ndërkombëtarë, të cilët e kanë ndihmuar Kosovën në të gjitha fazat dhe ky do të jetë një hap i rëndësishëm i Kosovës në rrugën e saj të integritimit euroatlantike. Drafti final i statutit, në fund të procesit, bashkë me direktivën, do të dërgohen në Gjykatën Kushtetuese për t'u siguruar se janë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kosova me këtë hap përmbush edhe një obligim ndërkombëtar, duke dëshmuar përkushtimin në rrugën euroatlantike.



Emërohen anëtarët e rinj të Agjencisë së Akreditimit

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 4 PRILL - Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën propozimin për t'i emëruar anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) së Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA). Në këtë agjenci do të jenë nëntë persona, në mesin e tyre edhe tre ekspertë ndërkombëtarë.

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka thënë se personat e përzgjedhur në këtë bord janë të përgatitur profesionalisht. "Bordi përbëhet prej nëntë anëtarëve për një mandat prej pesë vjetësh. Bordi në përbërjen e saj ka të dy gjinitë, ka persona që janë aktivë në punën akademike, në arsimin e lartë dhe profesional brenda dhe jashtë Kosovës.

Bordin e përbëjnë tre ekspertë ndërkombëtarë që nuk janë të punësuar në asnjë bartës të arsimit të lartë në Kosovë", ka thënë Bytyqi.

Nëntë personat e propozuar nga MASHT-i janë: Vjollca Krasniqi, Arta Jakupi, Rozafa Koliqi-Lila, Magdalena Ziolo, Gazmend Luboteni, Herbert K. Amato, Xhavit Rexha, Jeffery Butel dhe Dukagjin Zeka.

Duke qenë në përputhje me rekomandimet e Kuvendit të Kosovës, ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, me kohë kishte formuar një grup pune për të hartuar një Udhëzim Administrativ, në hartimin e të cilit kontribuuan përfaqësues të institucioneve tona shtetërore, përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, të institucioneve ndërkombëtare që angazhohen në fushën e arsimit të lartë dhe njohës



të arsimit nga shoqëria civile. Duke u bazuar në këtë UA, MASHT brenda afateve kohore ka shpallë thirrje publike për nominimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).

Kjo thirrje publike është bërë pas vendimit të MASHT-it për ta rishikuar dhe rivlerësuar listën e të nominuarve për anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, në funksion të garantimit të zbatimit të standardeve më të larta akademike e profesionale dhe pavarësisë së domosdoshme të funksionimit të KShC-së.

Pas kësaj, ministri Bytyqi ka emëruar edhe një komision me integritet të lartë profesional, që ka vlerësuar nëse të nominuarit i plotësojnë apo jo kriteret akademike e profesionale sipas thirrjes së publikuar në faqen zyrtare të MASHT-it.

SBASHK-u, nëse nuk përmbushen kërkesat, fillon grevën javën e ardhshme

EPOKA E RE

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 4 PRILL - Përfaqësuesit e Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Kulturë dhe Shkencë (SBASHK) kanë ritheksuar ultimatumin e tyre që të miratohet Ligji për Punëtorët në Arsim të viteve të '90-ta në mënyrë që të evitohet greva e paralajmëruar më 13 prill.

Kryetari i rizgjedhur i kësaj sindikate, Rrahman Jasharaj, ka takuar të mërkurën ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, me të cilin ka diskutuar për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve për Ministrinë e Punës.

Ministri Reçica i ka informuar përfaqësuesit e SBASHK-ut, të udhëhequr nga kryetari Jasharaj, se në planifikimin buxhetor të kornizës afatmesme të shpenzimeve 2019-2021, MPMS-ja e ka përfshirë edhe Ligjin për punëtorët e arsimit shqip

që punuan në vitin shkollor 1990 deri në vitin 1999, të cilin propozim kjo ministri e ka përcjellë në Ministrinë e Financave.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka falënderuar ministrin Reçica për angazhimin dhe planifikimin e buxhetit për ligjin në fjalë në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2019-2021. Ai ka kërkuar të bëhen përpjekje në kuadër të Qeverisë, që meqenëse ky ligj është paraparë nga MPMS-ja në kornizën afatmesme të shpenzimeve 2019-2021, edhe përkundrazi që nuk është aprovuar ende në Qeveri, ligji në fjalë të kalojë në Qeveri dhe të procedohet në Kuvend.

Në këtë takim është bërë me dije se gjatë ditëve në vijim SBASHK-u do të bëjë përpjekje maksimale që t'i takojë edhe aktorët e tjerë në këtë proces, në mënyrë që kërkesat e SBASHK-ut të realizohen para datës 13 prill.



Bytyqi e Krasniqi bisedojnë për të dhënat statistikore në arsim



PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka pritur të mërkurën në takim kryesheffin ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), Isa Krasniqi dhe drejtorin e Departamentit të Statistikave Sociale, Avni Kastrati, me të cilin ka biseduar lidhur me raportimin dhe standardizimin e të dhënave statistikore në sektorin e arsimit. Bytyqi ka pohuar se MASHT-i

ka të dhënat e duhura për të gjitha nivelet e arsimit, por ato vazhdojnë të pasurohen dhe plotësohen në vazhdimësi, sipas trendëve, përfshirë këtu edhe regjistrimin e nxënësve apo studentëve në vitin shkollor, përkatësisht akademik. "Ne jemi në bashkëpunim edhe me Bankën Botërore që kjo çështje të bëhet në mënyrën më të mirë të mundshme, ashtu që të kemi databazën e nevojshme për hartimin e

politikave arsimore në të ardhmen. U pajtuam që brenda një kohe të shkurtër të hartohet edhe një marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale, ku do të saktësoheshin edhe obligimet dhe përgjegjësitë lidhur me raportimin e të dhënave statistikore për të gjitha nivelet e arsimit, sipas standardeve që kërkohen dhe aplikohen në vendet e Bashkimit Evropian", ka thënë Bytyqi.

Deputetët thonë se Kosova bëri veprim skandaloz me dëbimin e shtetasve turq

Deputetët e Kuvendit të Kosovës në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur të mërkurën rreth dëbimit të gjashtë shtetasve turq, të cilët ishin drejtues dhe mësues të Kolegjit "Mehmet Akif", vlerësuan se shteti i Kosovës bëri veprim skandaloz rreth mënyrës se si i ka deportuar ata në Turqi duke shkelur të drejtat e njeriut. Deputetët gjatë debatit theksuan se në këtë situatë mbeten të shtangur kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, por jo edhe presidenti

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 PRILL - Me nismën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe mbështetjen e dhënë nga 40 deputetë nënkohës të kësaj nisme, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të mërkurën seancë të jashtëzakonshme rreth dëbimit të gjashtë shtetasve turq, ngjarje e cila ka ndodhur më 29 mars, të cilët janë drejtues dhe mësues të Kolegjit "Mehmet Akif". Për këtë operacion drejtuesit e tri institucioneve më të larta të vendit, presidenti, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, kishin deklaruar se nuk kanë pasur informacione. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Avdullah Hoti, në fjalën e tij para deputetëve ka ngritur pikëpyetjen se si pesë nga gjashtë të arrestuarit, të cilët ishin punonjës të shkollave "Mehmet Akif", kanë mundur të paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare të vendit, ashtu siç e ka arsyetuar Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), arrestimin dhe dëbimin e këtyre shtetasve

turq. Siç ka theksuar ai, me këtë rast janë shkelur procedurat ligjore dhe të drejtat e qytetarëve turq të deportuar. "Ne të gjithë u shtangëm më 29 mars nga lajmi se gjashtë shtetas turq ishin kidnapuar dhunshëm në pikë të ditës, para nxënësve, kolegëve e familjarëve të tyre. Në vend se të intervistoheshin nga organet kompetente në Prishtinë, ata u deportuan me urgjencë në Turqi", ka thënë Hoti, duke shtuar se të shtangur kishin mbetur kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, por jo presidenti. Në lidhje me këtë rast Hoti ka hedhur faj në adresën e presidentit Hashim Thaçi. Duke e cilësuar gjendjen si dramatike, por me pasoja të parueshme për të deportuarit dhe familjet e tyre, LDK-ja ka propozuar që Kuvendi të nxjerrë një rezolutë për këtë rast. Përmes saj rezolute kërkohet që drejtori i Policisë, Kryeprokurori i Shtetit, drejtori i Agjencisë për Inteligjencë, ministri i Brendshëm, ministri i Jashtëm, ministri i Drejtësisë, autoriteti i aviacionit bashkë me ministrin e Infrastrukturës, brenda tri ditëve të raportojnë me shkrim në komisionin përkatës parlamentar për përgjegjësinë që kanë pasur dhe procedurat që kanë

ndjekur në këtë rast. LDK-ja ka kërkuar të formohet një komision hetimor parlamentar për ta zbardhur këtë rast, i cili u tha se ka cenuar rëndë të drejtat elementare njerëzore. "Përgjegjësit e këtij skandali të japin llogari bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi", thuhet në qëndrimet e LDK-së të cilin e ka lexuar Avdullah Hoti. Deputet i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se ngjarjet e javës së kaluar që ndërlihdën me operacionin e deportimit të gjashtë shtetasve turq kanë shqetësuar opinionin dhe institucionet e Kosovës. Ai ka theksuar se askush nuk mund të rrijë indiferent ndaj mënyrës se si është zhvilluar aksioni i arrestimit dhe deportimit të këtyre qytetarëve nga Turqia. Por, Krasniqi nuk është pajtuar që tani Kuvendi ta hedhë barrën e fajësisë mbi një individ apo institucion përpara se rasti të mos jetë sqaruar deri në fund. "Edhe pse ka kaluar gati se një javë, asnjëri prej nesh nuk kemi asnjë raport e as një informacion zyrtar për arsyet, rrjedhën dhe efektet e këtij veprimi. Edhe qëndrimet tona janë të varura nga kjo mungesë e informatave, por edhe nga deklaratimet e deri-

tashme të liderëve dhe të bartësve institucionalë. Besoj se të gjithë mund të pajtohemi se sot, me shumë se çfarëdo tjetër, ajo që na duhet është qartësia lidhur me veprimet që kanë ndodhur. Kur flas për qartësi, mendoj për atë që shkon përtej informatave dhe copëzave të informatave që janë dhënë deri më tash në publik", ka thënë Krasniqi. Në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje ka folur deputeti Glauk Konjufca. Ai ka thënë se arrestimi i shtetasve turq që kanë pasur leje qëndrimi në Kosovë ka shpërfaqur të gjitha defektet e pushtetit në Kosovë. Sipas Konjufcës, arrestimi dhe deportimi i gjashtë shtetasve turq do të ketë edhe pasoja për Kosovën. "Dikush u bë shkaktar në Kosovë, që shteti ynë të renditet në mesin e atyre pak shteteve në botë, të cilat i shkelin konventat më të njohura ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Pas këtyre praktikave, një shtet i tillë nuk mund të thotë se është në Evropë, pra nuk i takon Evropës. Këto janë konsekuencat më të rënda për Kosovën në aspektin ndërkombëtar. Aspekti i dytë është ai i brendshëm kushtetues. Faktikisht u shkel Kushtetuta e

Republikës së Kosovës, sepse në aspektin e të drejtave të njeriut Kushtetuta jonë mbahet si një Kushtetutë goxha e avancuar", ka deklaruar Konjufca. Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Ahmet Isufi, ka thënë se rasti i gjashtë shtetasve turq ka tronditur Kosovën për shkak se, sipas tij, këto veprime kanë qenë antikushtetuese dhe antiligjore. Bilall Sherifi në emër të grupit parlamentar të Nismës Socialdemokrate ka thënë se njerëzit e institucioneve të Kosovës kanë vepruar në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën Ndërkombëtare kur kanë rrëmbyer gjashtë shtetasit turq dhe ia kanë dorëzuar Turqisë. Sherifi ka thënë se rrëmbimi i gjashtë shtetasve turq dhe dorëzimi i tyre është krim për të cilin duhet të jepet llogari nga të gjithë. Ndërkaq deputeti i komunitetit turk, Fikrim Damka, i ka dalë në mbrojtje arrestimit dhe dëbimit të gjashtë shtetasve turq të cilët javën e kaluar u ekstraduan në Turqi. Ai në fjalimin e tij në Kuvend ka thënë se këta persona kanë paraqitur rrezik për Kosovën. Sipas deputetit Damka, njerëz të organizatës "FETO" në Kosovë janë marrë edhe me punë të tjera.



Thaçi nuk e dekreton Ligjin për shoqëritë tregtare, e kthen në Kuvend për rishqyrtim

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në mbështetje të nenit 80 dhe nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka marrë vendim për kthimin në rishqyrtim të Ligjit Nr. 06/L - 016 për Shoqëritë Tregtare, të miratuar më 15 mars 2018 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Presidenti i Republikës së Kosovës vlerëson se futja e kuotës së ndërlihdur me gjininë vetëm për bordet e drejtorëve të shoqërive aksionare, siç është bërë në Nenin 34 të Ligjit Nr. 06/L - 016 për Shoqëritë Tregtare, duke përjashtuar llojet e tjera të shoqërive tregtare, përmes të cilave mund të zhvillohen

veprimtaritë ekonomike në Kosovë, ngushton zbatueshmërinë e garancive kushtetuese dhe ligjore për barazinë gjinore. Gjithashtu, nuk është praktikë e zakonshme as ekzistimi i dispozitave ligjore që rregullojnë pjesëmarrjen në bordet e drejtorëve të shoqërive aksionare nëpërmjet kuotave gjinore.

'Trepça' bëhet me bord

Esat Peci, Feriz Fetahu, Xhaver Nura, Shyqeri Sadiku, Ardian Sylja dhe Naser Peci janë emëruar anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të "Trepçës". Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se ky bord do të plotësohet edhe me tre anëtarë të tjerë në ditët e ardhshme

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 PRILL - Qeveria e Kosovës ka miratuar të mërkurën propozimin e komisionit rekomandues për emërimin e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të "Trepça, Sh. A.". Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se po e përmbyllin kështu zotimin e Qeverisë për kompletimin e të gjitha bordeve. "Komisioni rekomandues për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit Mbikëqyrës të 'Trepçës' i ka përfunduar të gjitha procedurat sa i përket përzgjedhjes së anëtarëve të bordit, ka mbajtur intervistat dhe i ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës listën me kandidatët e propozuar për këtë bord. Bazuar në rekomandimin e Bordit, propozohen këta kandidatë: Esat Peci, Feriz

Fetahu, Xhaver Nura, Shyqeri Sadiku, Ardian Sylja dhe Naser Peci. Pra, këta janë gjashtë anëtarë të bordit, kurse tre të tjerë mbeten për t'u plotësuar në një etapë të ardhshme", ka thënë Haradinaj.

Qeveria ka miratuar edhe Projektligjin për Institucionet Mikrofinanciare, qëllimi i të cilit është rregullimi i licencimit, veprimtarisë dhe mbikëqyrjes së institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare në Republikën e Kosovës. Në mbledhjen e sotme u aprovua edhe Rregullorja për Menaxhimin e Projekteve në Fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, përmes së cilës bëhet përcaktimi i standardeve dhe rregullave unike për inicimin, planifikimin, ekzekutimin, monitorimin dhe kontrollin, si dhe përmblyljen e



procesit të menaxhimit të projekteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, në institucionet e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Kosovës mori vendim edhe për themelimin e Grupit Punues Teknik me qëllim të propozimit të zhvillimit të

Minierës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës dhe miratoi nismën për negocimin e Marrëveshjes me Republikën e Shqipërisë lidhur me njohjen reciproke të patentë shoferëve. Po ashtu, u aprovua nisma për negocimin e Marrëveshjes me Qeverinë e Mbretërisë së Arabisë

Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital, e cila do të zbatohet për tatimet në të hyra të vëna në emër të shtetit kontraktues apo të nëndivizioneve të saj politike apo autoriteteve lokale, pavarësisht prej mënyrës se si vjelen ato.

Bruto Produkti Vendor shënon rritje 3.2 për qind



PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Bruto Produktin Vendor" (BPV) për tremujorin e katërt (TM4) 2017, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstante. Sipas ASK-së, BPV-ja në TM4 të vitit 2017 ka shënuar rritje reale për 3.2 për qind, në krahasim me TM4 të vitit 2016. "Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon: aktivitetet financiare dhe të sigurimit (30.4 për qind), industria përpunuese (7.4 për qind), transporti dhe magazinimi (6.8 për qind), tregtia me shumicë dhe pakicë (5.7 për qind), afarizmi me pasuri të patundshme (4.2 për qind), industria nxjerrëse (4 për qind), hotelet dhe restorantet (3.9 për qind), bujqësia, gjuetia

dhe pylltaria (3.4 për qind), dhe ndërtimtaria (2.6 për qind)", është thënë në njoftimin e ASK-së. Sipas ASK-së, rënie reale kishte në të dhënat e furnizimit me energji elektrike, ujë dhe trajtim të mbeturinave (22 për qind). "BPV-ja sipas qasjes së shpenzimeve ka pasur rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak në: eksportin e mallrave dhe shërbimeve (35 për qind), importin e mallrave dhe shërbimeve (6.67 për qind), formimin e bruto kapitalit (4 për qind), shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (3.5 për qind), shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe institucionet jopërfutuese në shërbim të ekonomive shtëpiake (IJPESHESH) (0.1 për qind)", është theksuar në njoftimin e ASK-së.

Ministri Gjijnuri nuk i kthen përgjigje Lekajt për Rrugën e Kombit

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, me të cilin ka diskutuar për zhvillimet e fundit në dy vendet tona, me

theks të veçantë për çështjen e taksës rrugore. Lekaj gjatë këtij takimi ka ritheksuar papajtueshmërinë e Kosovës me çmimin dhe mënyrën se si është marrë ky vendim për njëri nga arteriet kryesore të lidhjes ndërshtepëtare

Rrugës së Kombit. "Po ashtu, e diskutuam edhe letrën zyrtare me të cilën i jemi drejtuar ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës, Damian Gjijnuri dhe për mungesën e përgjigjes në këtë letër. Ishte pajtim i

dyanshëm që hapat e mëtutjeshëm të bëhen me pajtim të plotë", ka thënë Lekaj. Ai ka shtuar se Shqipërisë dhe Kosovës si dy vende vëllezërore u duhen marrëdhënie me influencë pozitive për zhvillimin e gjithëmbarshtëm.



OEK-u: Normat e larta të kamatave, sfidat kryesore në sektorin e ndërtimit



Mungesa e punëtorëve të kualifikuar, normat e larta të kamatave, hiperndërtimi, mospagesa e konsumatorëve me kohë, mungesa e parasë së gatshme, si dhe vështirësitë e pranimit teknik janë ndër barrierat kryesore me të cilat përballet sektori i ndërtimit

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 4 PRILL - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka prezantuar të mërkurën rezultatet e studimit rreth barrierave dhe mundësive të sektorit të ndërtimit në vend, të identifikuar në kuadër të indeksit të klimës së biznesit për tremujorin e katërt (TM4) të vitit 2017.

Kryetari i OEK-ut, Safet Gërxhaliu, ka thënë se ky studim është projektuar për t'i identifikuar dhe artikuluar pengesat e të bërit biznes dhe parashikimin e

trendëve të ekonomisë së vendit në periudhë tremujore dhe periudhë ciklike gjashtëmujore.

Gërxhaliu ka thënë se sektori i ndërtimit vazhdon të ballafaqohet me barrierat të shumta. "Pjesa dërrmuese e këtij sektori është mungesa e stafit të kualifikuar, konsumatorët nuk paguajnë me kohë, pastaj është kostoja e punës dhe mungesa e porosive. Një dukuri e cila vështirëson qasjen në financa është edhe mospranimi teknik i objekteve. Po ashtu, ndërmarrjet nuk investojnë në trajnime. 67 për qind e tyre thonë se punëtorët nuk kanë qenë

asnjëherë pjesë e asnjë trajnimit. Shqetësues mbetet edhe partneriteti me shkollat profesionale në këtë sektor", është shprehur ai.

I pyetur se sa korrespondon çmimi i lartë i ndërtesave në Prishtinë me standardin ekonomik në Kosovë, Gërxhaliu ka theksuar se kërkesa dhe oferta në këtë rast janë determinuese. Gërxhaliu ka thënë se sektori i ndërtimit në vendin tonë rezultoi të jetë mjaft optimist. "90 për qind e bizneseve të ndërtimit vlerësuan gjendjen e mirë në këtë sektor dhe vetëm 10 për qind e tyre e kanë vlerësuar gjendjen si të pafavorshme. Në pyetjen se sa për qind e të punësuarve posedojnë diplomë, 40 për qind e kompanive kanë deklaruar se punëtorët e tyre kanë diploma", ka thënë ai.

Olivera Ceni nga OEK-u ka prezantuar të gjeturat e raportit.

Ajo ka thënë se 90 për qind e kompanive të ndërtimit deklaruan se aktiviteti i tyre është i mirë, por barrierat kanë mungesën e punëtorëve të kualifikuar dhe normat e larta të interesit. "Gjendja e biznesit vlerësohet të jetë e kënaqshme. 90 për qind e tyre deklaruan se aktiviteti i tyre është i mirë. 52 për qind e tyre presin që situata e biznesit të përmirësohet, ndërsa 7 për qind e tyre presin që të përqeshohet situata e biznesit. Sipas kompanive ndërtimore 34.5 për qind e tyre thonë se numri i porosive janë shumë të vogla. Rreth 21 për qind e tyre presin rritje të çmimit të shitjes në tremujorin e parë të vitit 2018", ka thënë Olivera Ceni. Valon Vataj nga "KAWA Grup" ka thënë se sfidat në sektorin e ndërtimit janë të mëdha dhe

pothuajse janë të njëjta në të gjithë rajonin. Ai ka theksuar se siguria e punëtorëve në vendin e punës është e ulët. "Ndërtimi është një sektor i fuqishëm për zhvillimin ekonomik në vend. Mungesa e përkrahjes institucionale na bënë që ne të hasim në barrierat. Pothuajse 90 për qind e kompanive të cilat punojnë me institucionet publike janë në krizë", ka thënë Vataj.

I pyetur se pse çmimi i ndërtimit të vjetra është dukshëm më i lartë se i ndërtimit të reja, Vataj ka thënë se për shkak të ekspansionit të fushës së ndërtimit që nga paslufta, shpesh nuk janë përfillur kriteret dhe kualitetet e kërkuara. Kurse sa i përket çmimit mesatar për metër katror, Vataj ka bërë me dije se çmimi mesatar për metër katror i ndërtesave të reja në Prishtinë është 800 euro.

Lansohet aplikacioni për identifikimin e deponive ilegale

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në bashkëpunim me organizatën gjermane GIZ kanë organizuar të mërkurën ceremoninë e lansimit të aplikacionit për kërkesa të qytetarëve dhe identifikimin e deponive ilegale e

cila mban emrin "ndreqe.com". Kjo platformë është prezantuar edhe si aplikacion, i cili do të shërbejë për t'i lajmëruar parregullsitë, deponitë ilegale, rrugët e prishura apo çfarëdo problemi nga ana e qytetarëve. MAPL ka njoftuar se ky aplikacion do të ketë një ndikim poz-

itiv në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Në këtë aktivitet ishte e pranishme edhe ministrja e Ambientit, Albena Reshitaj, e cila ka theksuar se lansimi i kësaj platforme do të ketë rol pozitiv edhe për përmirësimin dhe ruajtjen e ambientit.

FOTOGRAFOJE



'Xixëllonjat' vizituan 'Epokën e re'



PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Fëmijët e grupmoshës katër deri në pesë vjeç, të institucionit parashkollor "Xixëllonjat" në Prishtinë, së bashku me edukatorët Elvira Racaj dhe Lumnije

Statovci-Purellku, kanë vizituar të mërkurën ambientet e gazetës "Epoka e re". Gjatë kësaj vizite ata janë pritur nga drejtori i gazetës "Epoka e re", Sadik Zeqiri.

Fëmijët e këtij institucioni janë njoftuar nga drejtori Zeqiri për punën që bëjnë redaktorët dhe gazetarët e gazetës "Epoka e re" dhe stafi tjetër i saj. Po ashtu, fëmijët kanë qenë shumë

kureshtarë të dinë se sa faqe shtypet gazeta, çfarë tirazhi, se a botohet kolor apo zi, kush e shet gazetën, kush e bën shpërndarjen e saj në kioska si dhe ku mund t'i gjejnë numrat

parë të gazetës. Fëmijët gjatë kësaj vizite kanë recituar vjersha të poetëve shqiptarë dhe kanë treguar njohuri për rëndësinë e medieve të shtypura.



Vazhdojnë punimet në renovimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës 'Mensur Zyberaj'

RAHOVEC, 4 PRILL (ER) - Po vazhdojnë punimet në renovimin e objektit të Shtëpisë së Kulturës "Mensur Zyberaj" në qytetin e Rahovecit.

Renovimi i objektit ka nisur gjatë vitit të kaluar me renovimin e brendshëm dhe pas përfundimit të punëve përbrenda objektit, punimet janë duke vazhduar në renovimin e jashtëm të objektit.

Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, Ervin Hoxha, ka thënë se në objektin në fjalë nuk

ka pasur ndonjë intervenim sikur ky që tani është duke u bërë. "Renovimi i brendshëm ka përfunduar dhe tani është duke u punuar në renovimin e jashtëm të objektit dhe shumë shpejt ky objekt do ta marrë pamjen tjetër. Ne në vazhdimësi do të jemi të përkushtuar që të investojmë për ofrimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e aktiviteteve kulturore në komunën tonë", ka thënë Hoxha.

Ky projekt financohet nga buxheti i Komunës së Rahovecit.

Mësimdhënësit mbajnë trajnim për zbatimin e korrikulës së re

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, kanë filluar trajnimin dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, të cilët nga viti shkollor 2018/19 do të fillojnë zbatimin në praktikë të këtij dokumenti zyrtar.

Ky trajnim po bëhet në funksion të implementimit dhe zbatimit me sukses të kurrikulës së re në institucionet edukativo-arsimore.

Kurrikula e re nga viti shkollor

2017 ka filluar implementimin në të gjitha shkollat e nivelit të arsimit parauniversitar, konkretisht në nivelin parafillor, fillor klasa e parë (I), klasën e gjashtë (VI) dhe klasën e dhjetë (X) në gjimnaze, ndërsa nga viti shkollor 2018/19 do të vazhdohet implementimi i KK-së edhe me klasën e II, VII dhe të XI në gjimnaze.

Ky dokument përcakton një koncept të ri filozofik, i cili do ta mundësojë kalimin nga kurrikula e bazuar në përmbajtje lëndore në një kurrikulë që pro-

movon dhe mbështetë zhvillimin e kompetencave. Kjo kurrikulë ndihmon nxënësit, të rinjtë dhe të rejtat, të eksplorojnë dhe kuptojnë botën rreth tyre, t'i ndërlihdin përvojat e tyre të të nxënimit me jetën e vërtetë dhe zhvillojnë kompetenca në nivel të lartë dhe në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.

Trajnimi për zbatimin në praktikë të korrikulës së re po zhvillohet në këto fusha: gjuhët dhe komunikimi, shkencat natyrore, shoqëria dhe mjedisi dhe në ciklin fillor.



Mitrovica ndërmerr aksion për zgjidhjen e kaosit në trafikun rrugor

Mitrovicë, 4 prill (ER) - Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në Komunën e Mitrovicës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë iniciuar aksionin

për largimin e automjeteve të cilat parkohen në vende që nuk janë të parapara për parkim. Drejtori i Infrastrukturës, Naser Muja, ka kërkuar nga qytetarët t'i respektojnë rregullat e

komunikacionit, në të kundërtën nga organet e rendit do të fillojë edhe aplikimi i gjobave. "Ky aksion nuk ka për qëllim që të ndëshkohen qytetarët e Mitrovicës por,

meqenëse jemi në sezonin kur pritet frekuentim edhe më i madh nga mërgimtarët, duam të sigurohet një lëvizje e lirë për të gjitha automjetet", ka thënë drejtori Muja.



Këndvështrimet për Kosovën, zërat nga Prishtina dhe Brukseli

Kosova arriti pavarësinë e saj para një dekade, tani rrugëton drejt anëtarësimit në BE

Nga Bekim Çollaku dhe Antonia BATTAGLIA

Qëllimi ynë është të japim një perspektivë të dyanshme mbi gjendjen aktuale të Kosovës dhe për rrugën së saj drejt BE-së. E kemi konsideruar interesante dhe të vlefshme që ta shohim anëtarësimin e ardhshëm të Kosovës në BE nga dy këndvështrime të ndryshme: Prishtina dhe Brukseli, ku në njërin anë theksi vihet më shumë në atë se çfarë do të duhej të bëjë BE-ja, ndërsa nga ana tjetër Brukseli vë theksin në përgjegjësinë e institucioneve të Kosovës për rrugën që duhet ndjekur më tutje. Këndvështrimi nga Prishtina vjen nga Bekim Çollaku, shef i stafit të presidentit të Kosovës, dhe ish-ministër për Integritet Evropian, kurse këndvështrimi nga Brukseli vjen nga Antonia Battaglia, studiuese në Qendrën për Teori Politike në Universitetin ULB në Bruksel.

Prishtina

Kosova si pjesë përbërëse e mozaikut që përbënë Ballkanin Perëndimor duhet të trajtohet si e barabartë me pesë partnerët e tjerë në rajon në kuadër të planeve të Bashkimit Evropian për zgjerim në këtë rajon të Evropës që nuk është pjesë e BE-së. Strategjia e Komisionit Evropian bënë dallime mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Disa prej tyre trajtohen si më të avancuara dhe kësaj u jepen objektiva më konkrete të anëtarësimit deri në vitin 2025, ndërsa të tjerëve nuk u jepen as hapat e saktë. Megjithatë, perspektiva e aderimit në BE është e fuqishme për të gjitha gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe do të ishte e gabueshme të lejohet që kjo paqartësi në tekst të kufizojë konkretisht Kosovën dhe integritetin e saj në BE. BE-ja e kupton që lënia pas dore e Kosovës do të ishte një gabim serioz strategjik. Qasja e tillë me të vërtetë do ta përkeqësonte gjendjen politike dhe ekonomike në Kosovë dhe rrjedhimisht në të gjithë rajonin. Strategjia për Ballkanin Perëndimor thekson fuqimisht domosdoshmërinë e zgjedhjes së mosmarrëveshjeve bilaterale para anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Megjithatë, që kjo të bëhet e mundshme, duhet që të gjitha 28 shtetet anëtare të BE-së të ritheksojnë se gjashtë

vendet e Ballkanit Perëndimor gëzojnë perspektivë evropiane. Fatkeqësisht, Këshilli i BE-së tashmë ka konfirmuar se tema e zgjerimit nuk do të jetë temë e diskutimit në samitin e Sofjes, që do të mbahet në muajin maj, e kjo është një mundësi e humbur.

Sa i përket mosmarrëveshjes bilaterale me Serbinë, si Kosova ashtu edhe Serbia janë të përkushtuara në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve. Por që të dyja i kanë dhënë besimin BE-së që të jetë ndërmjetësues i këtij dialogu për shkak të premtimit se zgjidhja e çështjeve mes dy shteteve do ta mundësojë anëtarësimin në BE. Nuk ka alternativë tjetër përveç dialogut dhe është e vështirë të theksohet sa duhet rëndësia e tij.

Ngjarjet që kanë ndodhur në Kosovë më 26 mars 2018 ku një zyrtar i shtetit të Serbisë hyri në Kosovë ilegalisht dhe në kundërshtim me procedurat e dakorduara reciprokisht dhe i cili më pas u arrestua nga policia e Kosovës, e dëshmon se sa i brishtë është stabiliteti në terren dhe se si gjërat mund të përshkallëzohen për të keq.

Siguria dhe stabiliteti në Evropë në masë të madhe varen nga aftësia për ruajtjen e paqes në Ballkanin Perëndimor.

BE-ja ka një historik të varfër sa i përket parandalimit të konfliktit dhe ruajtjes së paqes në rajon.

Mesazhi duhet të jetë i qartë: të gjitha mosmarrëveshjet bilat-

erale, përfshirë edhe ato mes Kosovës dhe Serbisë, duhet të zgjidhen para anëtarësimit në BE.

Vetëm kjo mund ta bëjë samitin e Sofjes si momentin ku perspektiva e anëtarësimit në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor bëhet reale.

Brukseli

Strategjia ambicioze e përcaktuar nga Komisioni Evropian për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE ka theksuar se Kosova ende ka punë për të bërë para se t'i plotësojë kërkesat për procesin e anëtarësimit. Kjo bën thirrje për reforma të thella dhe të qëndrueshme në fushën e sundimit të ligjit, pavarësisë së gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar, qeverisjes së mirë si dhe respektimit të të drejtave themelore. Për më tepër, duhet të zgjidhen mosmarrëveshjet kufitare përpara se të zhvillohet ndonjë bisedë për anëtarësim.

Rruga për në Evropë ka ndalimin e saj të radhës dhe që është më i rëndësishmi i cili mbahet në Sofje më 17 maj, pra samiti për Ballkanin Perëndimor i cili do ta paraqesë mundësinë për t'i thelluar zotimet e ndërsjella, për ta nxitur bashkëpunimin ekonomik dhe avancuar angazhimin e ndërsjellë për sigurinë, migrimin dhe, mbi të gjitha, për konjektivitetin e ndërsjellë.

Por, nëse strategjia ka për qëllim që të orientojë Kosovën drejt së

ardhmes, bashkësia ndërkom-bëtare duhet të angazhohet më qartë me një rrugë të detajuar drejt anëtarësimit në BE, duke ndërtuar partneritet efektiv dhe duke favorizuar pjesëmarrjen e institucioneve vendore në diskutimet përkatëse të politikave të BE-së.

Kosova duhet të 'rritet' brenda Evropës.

Siç edhe u dëshmuua në ngjarjet e fundit, Kosova ka ende një baraspeshë shumë delikate ku çdo veprim që lidhet me dialogun me Beogradin mund të bëhet pengesë për marrëveshjet e paqes.

Kosova duhet të zhvishet nga pasiguria që lidhet me statusin e saj dhe nëse perspektiva evropiane dëshiron të jetë e suksesshme, ajo duhet ta arrijë pjekurinë nëpërmjet fuqizimit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Një marrëdhënie reale. Integriteti i serbëve që jetojnë në veri dhe forcimi i pozitës së tyre brenda institucioneve të Kosovës duhet të bëhet pa kushte edhe pavarësisht asaj që ndodh në Beograd.

Vazhdimi i kushtëzimit të ndërsjellë të së ardhmes së Kosovës dhe Serbisë rrit presionin dhe e ngarkon më tej situatën e vështirë të brendshme. Udhëheqësit e Kosovës, në të njëjtën kohë, duhet të bëhen ambicioz, të guximshëm, t'i përvjelin mëngët më shumë se kurrë për realizimin e reformave për luftën kundër korrupsionit dhe kundër kimit, për ndryshime sociale si dhe për

investime në ekonomi dhe arsim.

BE-ja duhet të përballet me çështjen e liberalizimit të vizave dhe me çështjen e statusit.

Spanja (së bashku me Sllovakinë, Rumaninë, Greqinë dhe Qipron), duke mos qenë gati të njohin statusin e Kosovës, po bëjnë një gabim të madh politik i cili flet shumë për të kaluarën, por që nuk mund të gjejë vend në një perspektivë të gjerë evropiane.

Popullsia e Katalonisë nuk ka pasur luftë dhe rasti i Kosovës asnjëherë nuk mund të krahasohet me gjendjen aktuale politike të brendshme të Spanjës.

Presidenti i Komisionit Jean-Claude Juncker deklaroi se Ballkanin Perëndimor beson në Evropë më shumë se 'ne' (ata që tashmë jemi 'evropianë' me pasaportë). Kjo është e vërtetë. Sakrifikimi i përparimit real për të ruajtur një stabilitet të jashtëm (të brishtë) në rajon ka dëshmuar të jetë joefektiv. Kosova ka nevojë për një të ardhme të re.

Dhe Evropa ka nevojë për një Kosovë të fortë.

(Bekim Çollaku është shef i stafit të presidentit të Kosovës dhe ish-ministër për Integritet në BE. Antonia Battaglia ka qenë zyrtare e OKB-së në Kosovë dhe është studiuese në Qendrën për Teori Politike në Universitetin ULB në Bruksel, autore e një libri për Kosovën dhe shkruan për Balkan Insight)



Trumpi: Askush nuk ka qenë më i ashpër sesa unë ndaj Ruisë

"Askush nuk ka qenë më i ashpër ndaj Ruisë. Por, mendoj se mund të kem një marrëdhënie të mirë me presidentin Putin. Nëse nuk është e mundur, atëherë ju do ta kuptoni këtë", tha presidenti Trump



WASHINGTON, 4 PRILL - Mes kritikave mbi ftesën që i bëri presidentit rus Vladimir Putin për të mbajtur një takim së shpejti në Shtëpinë e Bardhë, presidenti Donald Trump tha se askush nuk është më i ashpër ndaj Ruisë sesa ai. Disa ekspertë thonë se Rusia ka të ngjarë të kërkojë një takim të tillë të nivelit të lartë për t'iu kundërvënë perceptimit se vendi është izoluar pas helmimit të një agjenti të dyfishtë rus dhe vajzës së tij në Britani. Perëndimi ndërmori veprime të koordinuara duke dëbuar diplomatë rusë si kundërpërgjigje ndaj helmimit të agjentit në Britani, për të cilin Londra ka akuzuar Rusinë. Pas një takimi me udhëheqësit e tre vendeve baltike të martën, gazetarët e pyetën presidentin Trump lidhur me kërcënimin nga Rusia dhe marrëdhëniet e tij me presidentin rus Vladimir Putin. "Askush nuk ka qenë më i ashpër ndaj Ruisë. Por, mendoj se mund të kem një marrëdhënie të mirë me presidentin Putin. Nëse nuk është e mundur, atëherë ju do ta kuptoni këtë", tha ai.

Presidenti Trump tha se nën udhëheqjen e tij Shtetet e Bashkuara janë përqendruar në eksportimin e sasive më të mëdha të naftës dhe të gazit dhe në rritjen e investimeve në ushtrinë amerikane, dy gjëra që ndoshta nuk i pëlqejnë Ruisë. Por ekspertët thonë se për-

shkallëzimi i tensioneve pas helmimit të një agjenti të dyfishtë rus në Britani, për të cilin Rusia thotë se nuk është përgjegjëse, e bën të papërshtatshme kohën e ftesës së presidentit Trump drejtuar Putinit për një takim në Shtëpinë e Bardhë. "Kjo nuk është koha për ta ftuar presidentin Putin në Shtëpinë e Bardhë për një takim shtetëror me nderime të larta, kur ju në thelb po dëboni diplomatët rusë", thotë Mark Simakovsky nga Këshilli Atlantik. "Komunikimi i rregullt me presidentin Putin është një gjë e përgjegjshme dhe diçka që e kemi bërë me rusët edhe në kulmin e Luftës së Ftohtë. Por, është kohë e gabuar për mbajtjen e një takimi në Moskë ose në Uashington", thotë analisti Luke Coffey nga Fondacioni Heritage.

Hera e fundit që një president rus u ftua për një takim në

Shtëpinë e Bardhë ishte në vitin 2005, nga ish-presidenti George W. Bush. Ekspertët thonë se anëtarët e ardhshëm të ekipit të sigurisë kombëtare të presidentit Trump ka të ngjarë ta kundërshtojnë ftesën e tij.

"Pra, nëse ai dëshiron, është shumë e mundur që kjo të ndodhë, por do të ketë rezistencë të konsiderueshme në Shtëpinë e Bardhë për këtë. Unë mendoj se këshilltari për sigurinë kombëtare Bolton dhe sekretari i ardhshëm i Shtetit, Mike Pompeo, do të kenë rezerva të forta për kohën e një takimi të tillë", thotë eksperti Mark Simakovsky.

Ekspertët e tjerë thonë se rusët kanë synuar të sigurojnë një ftesë që kur presidenti Trump mori detyrën. "Rusët kanë kërkuar një takim të tillë që kur presidenti Trump fitoi zgjedhjet. Ata panë se si

marrëdhëniet e ShBA-së me Kinën, Japoninë dhe me vende të tjera u përmirësuan pasi

presidenti Trump u takua me udhëheqësit e tyre", tha Richard Weitz nga Instituti Hudson.

Franca dhe SHBA-ja, të përkushtuara për shkatërrimin e IS-it

PARIS, 4 PRILL - Franca dhe Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara ta shkatërrojnë grupin militant Shteti Islamik, tha zyra e presidentit francez, Emmanuel Macron, pas bisedës së këtij të fundit me homologun amerikan Donald Trump. "Franca dhe ShBA-ja janë të vendosura të vazhdojnë veprimet e tyre brenda koalicionit ndërkombëtar për ta luftuar deri në fund këtë organizatë terroriste", tha përmes një deklaratë Pallati Elysee. "Asgjë nuk do të na largojë nga synimi për ta parandaluar ringjalljen e Shtetit Islamik në rajon dhe për të mundësuar një proces politik gjithëpërfshirës në Siri", thuhet në deklaratë. Lufta civile në Siri ka nisur qysh në vitin 2011. Mbi 360 000 njerëz janë vrarë dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë.

Bejli: Maqedonia, mundësi reale për t'u bërë pjesë e NATO-s

SHKUP, 4 PRILL - Maqedonia ka mundësi që në një të ardhme të afërt të anëtarësohet në NATO, kështu është shprehur ambasadori amerikan Xhes Bejli në debatin e organizuar në ditën e NATO-s. Bejli shpreh optimizëm rreth situatës aktuale në Maqedoni duke nënvizuar nevojën e përbushjes së reformave që, sipas tij, nuk duhet të mbesin vetëm në letra, por të gjejnë

zbatim edhe në praktikë. "Ajo çfarë është e re mendoj se ekziston një mundësi reale se Maqedonia së shpejti do t'i bashkohet Aleancës. Po çfarë me të vërtetë kjo do të thotë për Maqedoninë dhe qytetarët e këtij vendi? Kjo do të thotë se ju do të jeni aleatë dhe jo partnerë, miq, apo fqinjë. NATO është një Aleancë e ndërtuar në vlera të larta. Vendet që i bashkohen Aleancës marrin

vendimin të përqafojnë këto vlera. Maqedonia ka pranuar se kohët e fundit është në një rrugë të reformave dhe mendoj se është e rëndësishme që këto reforma të ecin", tha ambasadori amerikan Xhes Bejli.

Ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska, tha se anëtarësimi i vendit në NATO do të jetë një hap i rëndësishëm jo vetëm për aspektin e

sigurisë, por edhe për progresin ekonomik të vendit. "Ajo që është e rëndësishme është se 10 muajt e fundit kemi treguar se demokracia në Maqedoni nuk është e humbur. Ne kemi dëshmuar se Maqedonia është e vetëdijshme që fillimisht vetë duhet t'i zgjidhë problemet e veta dhe t'i mbulojë mangësitë e veta. Megjithatë, tani është momenti kur ne mund ta



kërkojmë edhe mbështetjen tuaj për shkak të rezultateve që i kemi arritur. Anëtarësimi në NATO është një argument i madh politik, veçanërisht për të rinjtë që të kenë besim më të madh në vete dhe në vendin e vet", deklaroi Sheqerinska.

'Intervenimi i NATO-s në Kosovë', dëshmi historike

Prof. asoc. dr.
Fahredin SHABANI

Derisa e rilexojë librin e Nusret Pllanës, "Intervenimi i NATO-s në Kosovë" me qëllim shkrimin e këtij recensionit me rastin e promovimit, ndieja trysninë e trishtimit që natyrshëm kaplon secilin kur lexon e rilexon një tekst që synon të ndriçojë një kapitull të lavdishëm historie të kombit tonë, ngjarjet e të cilat kemi përjetuar të gjithë ne, të cilat, deshëm apo nuk deshëm, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në profilin tonë psikologjik. Për më tepër, një ndjenjë të tillë trishtimi vetëm sa e gravon fakti se autori i këtij libri shquhet për botimin e librave e materialeve të tjera dokumentare që pasqyrojnë, në përmasa që shkaktojnë trauma psikologjike për njeriun normal, masakrat shekullore që Serbia ka bërë ndaj shqiptarëve.

Ndonëse i botuar shumë vjet më parë, libri që e kemi në dorë është vepër shumë aktuale që përshkruan të gjitha rrjedhat e ngjarjeve që shpiten në çlirimin e Kosovës. Autori, me një stil mbresëlënës, fillon me përshkrimin dhe ndërtimin e një konteksti shumë të gjerë, krejt në funksion të asaj që është tema bosht e këtij studimi, e që është intervenimi i NATO-s në Kosovë, të zbërthet sa më mirë nga lexuesi.

Në kapitullin e parë, autori Pllana bën një përshkrim të thuktë të ngjarjeve të fundshekullit XX, më konkretisht fundin e Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjen e BRSS-së, duke përshkruar përballjen e politikave të Reganit e Gorbaçovit dhe rolin e tyre në ngjarjet dhe zhvillimet ndërkombëtare, të cilat zhvillime më pastaj do të jenë vendimtare për formatin politik, ekonomik e ushtarak të globit. Siç edhe pritet nga një studiues

serioz, sikundër është z. Pllana, ai me përshkrimin që i bën Paktit të Varshavës dhe veprimtarisë së tij në kapitullin e parë, ndërton kontrastin e nevojshëm që ndihmon shumë për të vënë në pah mjaftueshëm aktorin tjetër kryesor ndërkombëtar, që është boshti kryesor i studimit, pra NATO-n.

Shpërbërjen e Jugosllavisë, autori, duke i mbështetur tezat e tij edhe në tezat e disa autorëve të tjerë ndërkombëtarë, përveç konflikteve të shtresuara etnike, ia atribuon edhe rënies ekonomike. Duke vazhduar përshkrimin kronologjik, gjithnjë në funksion të ndërtimit të kontekstit sikundër u tha më lart, autori shtjellon arsyeshtëm fillimin e shpërbërjes së Jugosllavisë, masakrat në Bosnje, Kroaci etj. Po ashtu, brenda këtij kapitulli përshkruhet edhe zbarkimi jo fort i lavdishëm i trupave të huaj në Bosnje në kuptim të parandalimit të masakrave, disa nga të cilat edhe u kryen në mënyrën më mizore edhe në praninë e këtyre forcave të huaja.

Kapitullin e II autori e fillon me një përshkrim të gjendjes në Kosovë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, për të vazhduar me demonstratat e vitit '81, të cilave autori ia atribuon rolin qendësor në çarjen e Jugosllavisë pas vdekjes së Titos dhe, po ashtu, ua atribuon edhe rolin e sproves për Evropën për sa i takon çështjes së vetëvendosjes së popujve e barazisë së popujve. Përshkrimi i ngjarjeve rrjedhë natyrshëm me gjendjen gjithnjë e më të rënduar në Kosovë, heqjen e autonomisë, themelimin e partive të para postkomuniste etj.

Kapitullin e III autori Pllana e hapë me përshkrimin e, ta quajmë, komponentit të dytë të studimit të tij, atë të NATO-s. Edhe këtu autori tenton që kronologjikisht, shterueshëm e në detaje, të përshkruajë sferën ndërkombëtare



dhe NATO-n si pjesë e kësaj sfere. Një përshkrim i tillë detaj i ndihmon lexuesit t'i zgjerojë njohuritë e tij përkatëzi me këtë formacion politik e ushtarak, që u ka dhënë udhë shumë rrjedhave politike e ushtarake që nga themelimi i saj, gjatë Luftës së Ftohtë dhe pas saj, e deri në ditën kur po flasim. NATO gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë dhe deri në kohën e rënies së Murit të Berlinit, u bë kuadri kryesor institucional i zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet aleatëve perëndimorë, i cili kishte për synim të vetin kryesor dobësimin e Bllokut Lindor.

Mbarimi i kësaj lufte (Luftës së Ftohtë) krijoi një ambient tjetër politik, ushtarak e strategjik, që u përcoll me krijimin e orientimeve dhe qasjeve të reja në fushën e sigurisë, e që mundësoi ndërrimin e perceptimit rreth rreziqeve të mundshme dhe përgjithësisht sistemit të sigurisë. Fundin e kapitullit të III autori e rrumbullakon me përshkrimin detaj të ngjarjeve dhe dhunës së shfrenuar të pushtetit serb e, po ashtu, edhe krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në kapitullin e IV përsëri kronologjikisht përshkruhet Kosova

gjatë kuvendëve të ndryshme botërore, si Kongresi i Berlinit, Konferenca e Londrës, Versajës, Parisit, Dejtonit dhe, po ashtu, përshkruhet lëvizja e çështjes së Kosovës gjatë viteve '90, si Konferenca e Hagës, Samiti i Romës, Brukselit, Uashingtonit, Rambujesë etj.

Kapitullin e V autori e nis me një referencë të ndërhyrjes humanitare që në shekullin e XIII të Toma Akuini, për të vazhduar te studiuesit e mirënjohur të të drejtës ndërkombëtare, Hugo Grosi dhe Openheim. Këtu ai u referohet edhe grupeve të tëra studiuesish përkatëzi me llojin e intervenimit humanitar dhe mënyrës dhe kohës se si dhe kur ai duhet të bëhet. Gjithashtu, në këtë pjesë, ai bën sqarimin e gjerë lidhur me Konferencën e Rambujesë, intervenimin e NATO-s dhe spastrimin etnik me përmasa biblike, të paparë në këtë pjesë të Evropës që nga Lufta e Dytë Botërore. Kapitullin e përshkon një nxjerrje e tillë detajesh pothuajse në formë ditari për gati secilin aktivitet të UÇK-së në terren, selinë e NATO-s dhe çështje të tjera që shuajnë kureshtjen e lexuesit për një periudhë sa të dhimbshme, aq edhe krenare të historisë sonë.

Kapitulli VI përmbledhtazi në formë rekapitullimi përshkruan edhe një herë gjithë materien bazë që përbën strukturën bosht të librit dhe, po ashtu, edhe zhvillimet politike dhe të sigurisë në Kosovën e pasluftës.

Shikuar nga prizmi i një vlerësuesi objektiv, rëndësia e këtij libri që po e promovojmë sot del të jetë jashtëzakonisht e madhe, për shumë arsye. Autori i këtij libri ka qenë edhe vetë aktor në Luftën Çlirimtare, madje në një dimension jashtëzakonisht të rëndësishëm të saj, atë të informimit. Informimi përkatëzi me zhvillimet

gjatë luftës çlirimtare mund të themi lirish se ka luajtur rol kyç në përcaktimin e shumë rrjedhave, të cilat kulmuan me çlirimin e Kosovës.

Pikërisht për këtë fakt, pra për faktin e autorit-protagonist, ky libër mund të themi se nuk është i zakonshëm, duke qenë se bartë me vete edhe gjendjen psikologjike e shpirtërore, tundimin dhe ndërgjegjen e tij.

Një privilegj i tillë mund ta ketë vetëm autori protagonist, sikundër është rast i Nusret Pllanës. Buzë këtij privilegji qëndron edhe rreziku që, pothuajse, pashmangshëm e përcjell autorin-protagonist, të rrëshqasë në ndonjë subjektivizëm, i cili në këto raste, duke e njohur përmasën tragjike të rrugëtimit tonë historik, është i mirëkuptueshëm dhe nuk e zbehtë vlerën autentike të këtij studimi.

Veprat e tilla, zakonisht, sikundër e ka përmendur edhe vetë autori, shkruhen pas një distance kohore me ngjarjet, por duhet të thuhet se guximi i autorit për të shkruar edhe kur kjo distancë nuk është ajo e duhura, meriton të çmohet meritueshëm. Së bashku me distancën kohore nga ngjarjet që janë materie e këtij libri, besoj fort se do zhvillohet motivi i autorit, sepse guximi besoj nuk ka munguar e nuk mungon as sot, që ta kundrojmë me një dioptri më kritike historinë tonë politike, e cila dioptri kritike është indikator i maturimit tonë politik e shoqëror. Një ribotim i përplotësuar dhe i pasuruar edhe me këtë dioptri, do të risë edhe më cilësinë e librit dhe njëherësh do të bëjë që kjo vepër të jetë e patejkalueshme lidhur me këtë periudhë historike për brezat që vijnë.

(Ky fjalim është mbajtur me rastin e promovimit të librit "Intervenimi i NATO-s në Kosovë")



Hapet Zyra e Sekretariatit për nder të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani" është hapur të mërkurën Zyra e Sekretariatit për nder të shënimit të Vitit Mbarëkombëtar të heroit kombëtar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Në këtë hapje ka marrë pjesë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit,

Kujtim Gashi, i cili ka thënë se hapja e Zyrës së Sekretariatit është bërë në kuadër të përgatitjeve që po bënë Qeveria e Republikës së Kosovës për shënimin e Vitit Mbarëkombëtar të heroit Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. "Zyra e Sekretariatit do ta ketë rolin e koordinimit dhe organizimit të

të gjitha aktiviteteve të cilat do të zhvillohen me rastin e shënimit të Vitit Mbarëkombëtar", ka thënë ministri Kujtim Gashi. Ai ka njoftuar se Këshilli Organizativ së shpejti do ta bëjë publike agjendën shtetërore në të cilën do të jenë të përfshira të dy qeveritë, ajo e Kosovës dhe e Shqipërisë.



Stuhia diellore mund ta rikthejë qytetërimin në fillim të shekullit të 19



Një ngjarje jo e rrallë, por vetëm një herë në 20 “top plazma” e krijuar nga shpërthimet në Diell merr drejtimin e Tokës. Nëse do të kishite fuqinë e asaj që goditi planetin në vitin 1859, do të shkatërronte rrjetet e energjisë dhe sistemet e komunikimit. Nëse keni qenë dy ditë me hundën përjetë, duke menduar se mund të shihni satelitin kinez Tiangong-1 derisa bie në Tokë (fragmentet kanë rënë në Paqësor), përpiquni të imagjeroni të zgjoheni në mes të natës, me qiellin e ndezur deri ditën nga zjarri që kthehet nga e kuqe e thellë në jeshile smeraldi.

Nga radioja juaj e vjetër me bateri, e vetmja që nuk ka hile nga elektronika e shtëpisë, vijin lajme për aeroplanë të rrëzuar, zjarre, qytete të tëra në ngjarje të errëta dhe të izoluar, shkatërruese. Ju do të mendoni: Lufta e Tretë Botërore shpërtheu. Por jo. Sepse më shumë se një sulm bërthamor, ngjarja që po përjetoni ka një fushë të paimagjinueshme katastrofike: e aftë për ta sjellë botën në kushtet e epokës paraindustriale dhe bllokimin e saj për muaj, vite. Miliarda protone dhe elektrone

Mund të duhet një dekadë për t’u kthyer në kushte jetese të ngjashme me ato që dinim përpara “ngjarjes”. Për çfarë bëhet fjalë? Një stuhi elektromagnetike si ajo që, në vitin 1859, anuloi telegrafe të të gjithë botës. Por me shumë pasoja më të rënda, shkruan Roger Dube. Në artikullin e tij mbresëlënës, të marrë këtë javë nga Newsweek, profesori i shkencës i Institutit të Teknologjisë të Rochesterit tregon se çfarë mund të ndodhte nëse një stuhi e magnitudës që u regjistrua mbi 150 vjet më parë të godiste planetin sot:

“Kur në sipërfaqen diellore të dallohen ‘largimet koronale të masës’, çdo shpërthim dërgon miliarda protone dhe elektrone në një sferë të plazmës së mbinxehur, në sistemin diellor”. Ndodh që 1 në 20 prej këtyre sferave të plazmës të marrë një rrugë që kryqëzon orbitën e Tokës. Një e treta e shpejtësisë së dritës Nga një perspektivë shkencore, një stuhi diellore, ose më saktë “stuhia e rrezatimit diellor”, ndodh kur ka shpërthim magnetik në një shkallë të gjerë – e cila shpesh shkakton një shpërthim të masës koronale mbi sipërfaqen

e diellit – do të përshpejtojë grimcat e ngarkuara në atmosferën diellore me shpejtësi shumë të lartë.

Grimcat më të rëndësishme, protonet, mund të përshpejtohen në 1/3 e shpejtësisë së dritës ose 100 mijë kilometra në sekondë. Në këto shpejtësi, protonet mund të kalojnë 150 milionë kilometra nga dielli në Tokë në vetëm 30 minuta. “Kur të arrijnë në Tokë, protonet që lëvizin me shpejtësi depërtojnë në magnetosferë, – shpjegon qendra e parashikimit të motit hapësinor të Administratës Kombëtare Oqeanike dhe Atmosferike (Nora) – e cila mbron Tokën nga grimcat e ngarkuara me energji më të ulët. Pasi ndodhen brenda magnetosferës, grimcat udhëhiqen përgjatë linjave të fushës magnetike në një mënyrë të tillë që të depërtojnë në atmosferën pranë poleve veriore dhe jugore”.

Në qoftë se stuhia është më e vogël, ndodhin stuhitë gjeomagnetike si ato që ndodhën në mars 1989, Toka shkarkon një valë të energjisë elektrike në linjat e energjisë Hydro-Quebec, duke lënë 6 milionë njerëz pa energji për 9 orë. Nëse bëhet

fjalë për një fenomen më imponues si “stuhia e motit diellor”, stuhi të mëdha elektromagnetike, sasi të mëdha grimcash të ngarkuara kalojnë nëpër koronën diellore dhe arrijnë në Tokë, duke nxitur magnetosferën e Tokës.

Elektronet dhe protonet “janë përshpejtuar drejt linjave të fushës magnetike të Tokës, ku ato bien ndesh me atmosferën dhe jonosferën, veçanërisht në latitude të larta. Çdo komponent i motit ndikon në një teknologji. Në errësirë për vite, pa internet dhe pa ujë “Rreth tre ditë pas fillimit të stuhisë në Diell, planeti ynë përjeton atë që quhet stuhi hapësinor meteorologjike ose stuhi gjeomagnetike”. Nëse do të kishite fuqinë e asaj të vitit 1859, do të “skuqte” rrjetet elektrike të të gjithë planetit, do të shkatërronte rrjetet dixhitale dhe analoge të komunikimit, – parashikon një studim i Akademisë Kombëtare të Shkencave -. Ne do të mbetemi në errësirë prej vitesh. Pa internet.

Ndalohen industritë, transporti do të bllokohet. Do të përfundonte nafta dhe ndoshta edhe benzina e fundit e mbetur në cisternat e pompave që oper-

onin me energji elektrike. Ushqimi nuk do të arrijë në dyqane apo shtëpi. Do të na duhet të kultivonim në çdo cep të botës për t’u ushqyer. Uji duhet të nxirret nga lumenjtë ose pusët me dorë dhe ndoshta të dekontaminohet sepse impiantet e filtrimit nuk do të funksiononin më.

Ne nuk do të kishim frigoriferë apo ngrirës. Do të gatuanim në zjarret e drurit. Shpëtojmë falë energjive alternative Vetëm makinat elektrike mund të vazhdojnë të operojnë, me kusht që ato të mund të furnizohen nga termocentrale diellore ose me erë. Artikulli liston kundërmasat e mundshme: duke filluar me një ristrukturim të rrjeteve të energjisë elektrike në botë – të cilat duhet të ndahen në mikro-rrjetet, rrjetet e shpërndarjes që janë të izoluar nga njëra-tjetra, duke rritur përdorimin e burimeve alternative të energjisë për përhapjen e sistemeve diellore të familjes. Por nuk ka shumë kohë për t’u përgatitur: stuhia tjetër e madhe elektromagnetike mund të godasë në çdo moment. Dhe do të kishim një njoftim vetëm tri ditë para ndërprerjes.

(gazeta-Shqip.com)

Jay-Z: Kam qarë kur mamaja më tha se ishte lesbike



Reperi i famshëm Jay-Z ka qarë nga lumturia kur mamaja e tij i kishte thënë se ishte lesbike. "Isha aq e lumtur për të sepse më në fund ishte e lirë", ka thënë ai. Jay-Z i ka kushtuar këtij momenti këngën

"Smile" në albumin e tij të fundit 4:44. "Mami kishte katër fëmijë, por ajo ishte lesbike. Duhej të fshihej në një dhomë të errët. Kështu ka arritur ta mjekojë plagën. Turpi i shoqërisë dhe dhimbja ishte e madhe", ka thënë reperi Jay-Z.




Baby Gee si Rita Ora

Baby Gee së shpejti do ta publikojë projektin e saj më të ri. Këngëtarja për klipin e këngës së re ka zgjedhur të duket si Rita Ora me mantel banje, veshje kjo

me të cilën Rita u shfaq në MTV EMA. Kënga e re e Baby Gee's vjen pas projektit "Mos u nal" me të cilin arriti sukses dhe mblodhi miliona klikime në "Youtube".

Kim dhe Kanye kështu dukeshin në lidhjen e hershme të tyre



Channing Tatum dhe Jenna Dewan Tatum kanë njoftuar për vendimin e tyre për t'u ndarë pas pothuajse nëntë vjetësh martesë. Aktori 37-vjeçar dhe aktorka 37-

vjeçare u takuan në vitin 2006 dhe u martuan në vitin 2009. Channing dhe Jenna janë prindër të vajzës me emrin Everly, e cila do të bëhet pesëvjeçare muajin e ardhshëm.

Justin Timberlake ndihmon fansen për ta zbuluar shtatzëninë



Justin Timberlake ka ndihmuar një fansë për të bërë një njoftim të veçantë gjatë koncertit të tij. Gjatë performancës, një fansë i ka kërkuar këngëtarit ta

ndihmojë ta shpallte shtatzëninë e saj. Justini nuk ka ngurruar duke ndaluar shfaqjen dhe duke njoftuar se foshnja Baxtresser vjen në jetë më 1 nëntor 2018.

Autor: GAZMEND MORINA	DIPLOMATI I NJERË AMERIKAN NË FOTO	VINÇ	DIÇKA QË ESHTE E VERTETE (shq.)	EPOKË (shq.)	MOSHË E RE	ANITA TAKE	BANOR I NJË QYTETI SHQIPTAR NË MAQEDONI	EPOKA E RE	BASHKËTING-ËLLORE	QË I PËRKET ETIKES, E ETIKËS	VARIOLA	
KUMTIM I GJERË ME SHKRIM, QË MBAHET PËRA NJË MBLEDHJEJE	○							EPOKA E RE	AKTORI HOLLIVUDIAN ... GIBSON NË KETË MOMENT			
GAZ QË SHPËRTHEN KUR DIKUSH TALLET ME DIKË A ME DIÇKA	○								TITAN FILOZOF DHE MATEMATIKAN GREK			
VEGËL DORE, QË PËRBEHET NGA NJË KOKË METALI	○					DOKUMENTI I VJETËR MBI PRONËSINË E TOKËS PYLL						
ADVANCED VIDEO TECHNOLOGIES	○			SHALQI TË FRENUARIT							ELEMENT KIMIK	
EMËR YNI MASHKULLI (ANAGRAM I EMIRIT ARIF)	○				AFROHET (bised.) ELДАР (shk.)							
DY BASHKËTINGËLLORE	○		DRAMATURGU ARBËRESHË JOSIP ... LLOJ, SOJ (sh.shq.)					ANDORA EMËR I VJETËR PËR LUBJANËN		ZANORE TRAJNERI HOLANDEZ ... HAN		
BUJTINË E MADHE	○					ISH PRESIDENTI AMERIKAN RONALD BUKUROSHJA VUTHAJ						
KËNGËTARJA HUTA	○						VDEKJE BASHKËTING-ËLLORE					
SHKRONJA XVII	○	3.14 (Mat.) QYTET I LASHTË NË ILIRI (shq.)			KËNGËTARJA E NJOHUR ESTEFAN PJESE E ILIRISË						FEMRA E ARIUT ALFRED KAÇINARI	
KLUB FUTBOLLI GJERMAN "WERDER"	○					NAIM ABAZI TAJLANDA, INDIA			QË FLET A QË SHKRUAN SHKURT E PRERË AKTORI ... CRUISE			
RITUAL	○			SHTRESË E HOLLË BRUMI NË TRAJTË TË RRUMBULLAKËT (shq.) KËRSHITJE				BASHKËTING-ËLLORE QYTET NË SHQIPËRI (pashq.)			LOKAL LUKSOZ KU LUHET BIXHOZI TRIESTINA	
UGANDA, ZAMBIA	○		FEMRA E ZGJEDHUR NË NJË KONKURS BUKURIE QYTET NË ZVICËR				KOHË PA NDONJË DOBI				DITA E SHËNUAR NË KALENDAR KËNGËTARJA VALENTINA	SHTET NË EVROPË
SËMUNDJE E RËNDË NGJITËSE	○					AKTORJA AM. BASINGER NDARJE NË NJË NDËRMARRJE PRODHUESE					AKTORJA HOLLIVUDIANE ZELLUEGER SHITETI MË I POPULLUAR NË BOTË	ZANORE ANIMACION
EPOKA E RE			BOKSIERI SHQIPTAR ... SEFERI KRYENGRITJA KUNDËR PUSHTETIT			DETYRË E AKTORIT IMBECILI, IDIOTI			INTERESI BANKAR NGA KREDIA (sh.shq.) ISH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH			
KRYEQYTETI I LETONISË					SHPËRTHIMI I FUQISHËM RADIUM							PJATA SEND QË SHËRBEEN PËR ZBUKURIM (shq.)
ZANORE		KAFSHË E VOGËL HELMUESE ME NGJYRË TË ZEZË GOJËTAR					KËNGËTARJA AMERIKANE ... TARNER KA A DEM I PATREDHUR					MËNYRË E VEÇANTË E TË SHKRUARIT LUMË NË KOSOVË
ISH KRYEQYTETI I GJERMANISË (pashq.)				KRYEMURG PJESA E NGRITUR E TEATRIT KU LUAJNË AKTORËT				MIMOZA AHMETI REKRUT NË PERANDORINË OTOMANE			ENEIDA TARIFA SHKENCËTARI NJUTON (shq.)	BREJTËS I VOGËL NIKEL
KËNGËTARI ITALIAN RAMAZZOTTI					AKTORJA JONË CAHANI PËREMËR VETOR						QESËNDI ZANORE	LUMË NË MITROVICË
NOTË MUZIKORE			KËNGËTARE E JONA E NJOHUR SHKRONJA XXIV									
PARA TË KATËRTIT						NJË KONTINENT SAMI KHEDIRA			VENDI KU LIDHEN ESHTIRAT DY BASHKËTINGËLLORE		TONI ADAMS	BASHKËTING-ËLLORE MOR, HEJ
"MOLDE"			NATRIUM BASHKËTING-ËLLORE			NUK KA (bised.) KANDAHARI				SKITAR ZANORE		
KËNGËTARJA LIBOHOVA					KUVENDI KOMUNAL			MI I VOGËL				100 M ²



EPOKA E RE INSTITUCION I LARTË SHKENCOR KËNGËTARJA RADI BASHKIM I FORTË DHE I PANDASHËM (sh.shq.) ISH MISS ALBANIA HYGERTA BINARI I TRENTIT

E rrallë

Aksidentohet kamioni me elefantë

Një elefant ngordhi dhe disa të tjerë përfunduan lirshëm në një autostradë spanjolle pasi kamioni i cirkut në të cilin ata po transportoheshin u përplas në autostradë. Policia u detyrua ta mbyllte autostradën 'Poza Canada' pranë Albacete në juglindje të Madridit derisa u largua kamioni dhe elefantët e ngordhur.



FOTO E DITES



Pasagjerët ndihmojnë një grua që ra në shinat e hekurudhave në një stacion të trenit në Paris. /AP/

E jashtëzakonshme

Tasi i rrallë shitet për 30 milionë dollarë

Një tas jashtëzakonisht i rrallë i dinastisë Qing, i bërë për perandorin kinez Kangxi, u shit në ankand për 30.4 milionë dollarë. Ena me diametër 14.7 cm është e zbukuruar me kombinimin e teknikave kineze dhe perëndimore, si edhe lule që janë shumë të rralla në porcelanin kinez.



BARSOLETA E DITËS



Nxënësi: Mësuese, a dënohet dikush për diçka që nuk e ka bërë?
Mësuesja: Asnjëherë.
Nxënësi: Atëherë s'besoj se nuk do të më dënoni për detyrat që nuk i kam bërë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
 Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.

Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
 Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenaerts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
 Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Ka persona në jetën tuaj të


përditshme që po ju bezdisin dhe me të cilët e dini mjaft mirë që nuk mund të ndërmerri asgjë të përbashkët.



DEMI

Në ambientin e punës duhet të

krijoni kushte optimale për veten tuaj dhe për harmoninë midis kolegëve. Mos i vini re gjërat e vogla dhe pa rëndësi.



BINJAKËT

Keni kaluar limitet me një person

që ka besuar tek ju. Nëse sot doni t'i rregulloni raportet pala tjetër nuk ka aspak të njëjtin mendim.



GAFORRJA

Sot nuk keni pse tregoheni sipërfaqësor me problemet tuaja.

Duhet të shihni në detaje shenjat që ju jepen për të kuptuar se ku keni gabuar.



LUANI

Sot jeni shumë të zënë me punë dhe

për këtë arsye do të lini pasdore njerëzit tuaj të dashur. Momentet e humbura nuk ju kthehen me pas.



VI RGJËRESHA

Edhe pse nga të tjerët kërkon

shumë përkushtim kundrejt jush, ju vetë nuk jeni i gatshëm ta bëni këtë gjë për personat e afërt.



PESHORJA

Po kuptoni se personat që

qëndrojnë pran jush kanë interesa të tjera sesa miqësi reale. Do të filloni të mbani distanca dhe të tregoheni arrogant.



AKREPI

Duhet të krijoni përshlytje të pavarur nga

të tjerët për persona të caktuar sot. Jeni paragjykses dhe kjo gjë do t'ju prish punë personalisht.



SHIGJETARI

Dëshira dhe pasioni që kishit për

një person të caktuar është shuar. Ju desh pak kohë derisa ta kuptoni, por tashmë jeni të qartë.



BRICJAPI

Ata që ju duan nuk kërkojnë asgjë tjetër

përveçse lumturinë tuaj. Duke mos e kuptuar këtë gjë do të lëndoni pa masë një mik të afërt.



UJORI

Jeni me të hapur me ata që sapo i

njihni sesa me personat afër jush. Keni frikë që mos të zbulojnë një sekret tuajin ose kërkojnë diçka që s'mund ta realizoni.



PESHQIT

Jeni duke punuar për të

ardhmen tuaj dhe po e mendoni mjaft seriozisht mundësinë për të lëvizur diku tjetër.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
 "BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	ARSENAL - CSKA MOSCOW	GG3+	LAZIO - SALZBURG	3+	LEIPZIG - MARSEILLE	1
-------------------	-----------------------	------	------------------	----	---------------------	---

Gashi: Stadiumi i Prishtinës, gati në qershor

Ministri i Sportit, Kujtim Gashi, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri dhe zyrtarë të UEFA-së kanë inspektuar punimet në stadiumin e qytetit në Prishtinë. Ky stadium pritet të jetë i gatshëm në muajin qershor, me ç'rast do të organizohet edhe një ndeshje miqësore



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 4 PRILL - Stadiumi i qytetit në Prishtinë pritet të jetë i gatshëm në muajin qershor. Kjo është bërë me dije ditur pas një vizite që ka bërë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, i shoqëruar nga kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri, drejtori i Departamentit të Sportit, Ibër Alaj, si dhe zyrtarë të UEFA-së. Ata kanë parë nga afër punimet e bëra në këtë stadium, kurse ministri Gashi ka rikonfirmuar fuqishëm përkushtimin e tij si ministër që në qershor të këtij viti stadiumi i Prishtinës të jetë në funksion të zhvillimit të aktiviteteve sportive. "Që nga marrja e përgjegjësisë për ta drejtuar MKRS-në kemi qenë të përkushtuar që, përveç përmirësimit të infrastrukturës ligjore në sferën sportive, të angazhohemi maksimalisht edhe për përmirësimin e infra-

strukturës fizike nëpër të gjitha stadiumet sportive, me qëllim që ato të jenë në përputhje të plotë me kriteret dhe standardet e kërkuara nga autoritetet ndërkombëtare sportive", ka thënë Gashi.

Ndërsa kryetari i FFK-së, Fadil Vokrri, ka shprehur optimizëm se stadiumi i Prishtinës do të jetë i gatshëm në muajin qershor, kur pritet të zhvillohet edhe një ndeshje miqësore. "Bari duhet të testohet në ndeshje jozyrtare, pastaj në funksion të përfundimit të punimeve do të organizojmë një ndeshje inauguruese, por ajo mbetet pas testimit të barit, i cili do të bëhet me ndeshje jozyrtare dhe pa publik. Pastaj kemi planifikuar që nëse punimet përfundojnë sipas dinamikës së paraparë të zhvillohet edhe një ndeshje miqësore në fillim të muajit qershor", ka thënë Vokrri. Marrëveshja për rinovimin e stadiumit të kryeqytetit ishte nënshkruar në fillim të muajit qershor të vitit 2016, kurse të pranishëm me rastin e nën-

shkrimit ishin ministri i Drejtorinë e Infrastrukturës në së Futbollit të Kosovës (FFK), Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komunën e Prishtinës, Hysen Eroll Saliu dhe kryetari i Klubit Kujtim Shala, drejtori në Durmishi, sekretari i Federatës të Prishtinës, Remzi Ejupi.

Vokrri, Tahirit: Ndhimjojeni futbollin

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri, të mërkurën e vizitoi Komunën e Vushtrrisë, në vazhden e takimeve dhe vizitave në komunat e Kosovës, me qëllim që të kërkohet mbështetja e kryetarëve të komunave për klubet e futbollit. I pari i FFK-së është pritur nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri. "Fadil Vokrri e njohu kryetarin Tahiri për zhvillimet në futbollin e Kosovës dhe për prioritetet e FFK-së

për përmirësimin e infrastrukturës dhe i kërkoi që t'i jepet mbështetje klubeve të futbollit në përgjithësi, në veçanti në infrastrukturë si parakusht për zhvillimin e futbollit", thuhet në njoftimin e FFK-së. Në anën tjetër, kryetari Xhafer Tahiri, duke falënderuar Vokrrin për këtë vizitë, u zotua se komuna do t'i ndihmojë klubet e futbollit gjithnjë në bashkëpunim me federatën për t'u krijuar kushte sa më të mira për punë.

Prishtina afër finales, derbi kuqezi përfundon pa fitues



Prishtinë, 4 prill (ER) - Skuadra nga Liga e Parë, Vushtrria, ka dështuar ta befasojë në ndeshjen e parë skuadrën e Prishtinës, pasi ka pësuar humbje në Pejë me rezultat 1-0. Kryeqytetasit me këtë fitore e kanë bërë një hap të madh drejt kualifikimit në finalen e madhe. Rastin e parë në ndeshje e patën vushtrriasit në minutën e dytë nëpërmjet Jetmir Topallit, i cili gjuajti mbi portën e portierit "bardhekaltër". Golin e fitores për Prishtinën e

